



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 23. 05. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 10:00, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Ramë Buja, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini dhe Radmila Vujović.

Mungoi: Nexhat Daci.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit, me këtë

RENDITE

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 prillit 2008
2. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për lejimin e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 prillit 2008

U miratua procesverbali i mbledhjes së 22 prillit 2008.

2. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për lejimin e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Sabri Hamiti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Komisionin për Punë të Jashtme që ta shqyrtojë propozimin e Qeverisë për lejimin e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Propozimi i Qeverisë është: Ministrisë së Punëve të Jashtme t'i ndahen mjete financiare në vlerë prej 1 000 000, 00 (një milion) euro nga "Fondi për rezerva për implementimin e statusit".

Komisioni pas diskutimeve e nxori këtë

P ë r f u n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë propozimin e Qeverisë për lejimin e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme nga "Fondi për rezerva për implementimin e statusit".

3. Të ndryshme

Ibrahim Gashi - Tha se në fazën në të cilën po kalon procesi politik i njohjes së Kosovës si shtet, ndoshta është e nevojshme që ky komision t'i marrë edhe disa angazhime shtesë. Një ndër to do të ishte angazhimi i të gjitha institucioneve të Kosovës rreth punës së tyre që po e bëjnë për lobimin e njohjes së shtetit të Kosovës. Njëkohësisht duhet të bëhet edhe një llogaritje e mjeteve për aktivitete shtesë të Komisionit, për vizita të anëtarëve të këtij komisioni në disa shtete që hezitojnë ose nuk kanë qëndrim lidhur me njohjen e shtetit të Kosovës. Rruga nëpër të cilën po kalon legjitimimi i statusit të ri të Kosovës është komplekse, është legjitimim me anë të njohjeve individuale, prandaj tha se, për ta përmbyllur vitin me një numër më të madh të shteteve që do ta njohin Kosovën shtet të pavarur, kërkohen zhvillime të aktiviteteve gjer në muajin shtator.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

Kryetari i Komisionit
Sabri Hamiti

Procesmbajtësi
Minire Hasani